



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

**V E N D I M**

Nr. 14, datë 26.03.2025

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:**

**“OBERON TOWER” STRUKTURË SHËRBIMI DHE BANIMI ME 24 KATE MBI TOKË  
DHE 5 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “RESHIT PETRELA”,  
BASHKINË TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “O.B.E.R”sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

**VENDOSI:**


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Oberon Tower” Strukturë shërbimi dhe banimi me 24 kate mbi tokë dhe 5 kate nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Reshit Petrela”, Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues “O.B.E.R”sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kerkues vetëm pas:
  - a) plotësisht të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 19/11/2025